

E.S Financial Advisory shpk
Erjon Saraçi – AUDITUES LIGJOR
Licensa Nr.260, Date 27.08.2012
Adresa: Rruga Tefta Tashko Koço, Pall 132, Ap 1, Tirane
Mob. 0696002295
e-mail: erjons@gmail.com

Tiranë, më 22.08.2024

Lënda: Informacion në lidhje me mosrealizimin e shërbimit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë viti kalendarik 2023 për Partia Forca Rini

Për: Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve
Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri

Të nderuar zotërinj,

Me vendimin nr. 68, datë 5.7.2024, i KSHZ, “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjorë) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjekteve zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”, i ndryshuar, jemi caktuar me cilësinë e ekspertit kontabël (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2023 për 12 (dymbëdhjetë) Parti Politike, midis të cilave ishte dhe **Partia Forca Rini**.

Menjëherë pas lidhjes së kontratës **me KQZ-në**, më datë 27.07.2024, kërkuam të vendosim komunikimin zyrtar me **Partia Forca Rini** për fillimin e procedurave të auditimit, fillimisht nëpërmjet dergimit të Shkreses për fillimin e procedurave. Ne vazhdim Posta kthen shkresën për arsye se subjekti nuk gjendet [është i panjohur] në të pakten 10 vitet e fundit . Ne u perpoqem të identifikojmë adrese tjetër ose të gjejme kontakt të Drejtuesit të saj, por pa sukses.

Ne keto rrethana, është e pamundur të kryesh një angazhim auditimi për këtë subjekt pasi u perpoqëm të gjenim raporte të mëparshme nga ekspertët paraardhës në misione të ngjashme, si numra telefoni apo e-maile, nga kërkime në internet por edhe kjo mënyrë nuk solli rezultat.

Ne besojmë se kemi bërë përpjekjet e duhura për të vendosur komunikimin zyrtar me kryetarin dhe personat e tjerë përgjegjës në Parti por kjo që e pamundur dhe për rrjedhim misioni i auditimit për **Partia Forca Rini** nuk u realizua.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

E.S Financial Advisory shpk
Erjon Saraçi – AUDITUES LIGJOR

